



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
**Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec**



**P R O C E S V E R B A L**

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **19.06.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, z. **Arbër Zenuni**.

**Kryesuesi:** Fillimisht, përvendetje për të gjithë! I nderuar nënkyetar i komunës, z. **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **gjashtë (6)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

**R E N D   D I T E**

- 1. Shqyrimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor) ZK-Rahovec;**
- 3. Shqyrimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2028;**
- 4. Shqyrimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 nr.47/25, i datës 29.4.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);**
- 5. Të ndryshme.**

**Shtesë:** Shqyrimi i vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, 2026-2028.

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të KPF-së, e kemi edhe një pikë shtesë, që ka të bëjë me miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, 2026-2028.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përvendetje për kolegët-anëtarë e KPF-së, ekzekutiv dhe të gjithë të pranishmit. Nësë e kemi debatin e KAB-in. Buxheti është obligim i asamblesë komunale. A jemi në rregull proceduralisht nëse e vendosim në KPF, para se ta diskutojmë në diskutim publik? Mendoj që është hap i gabuar. Pres që konsultoheni edhe me ministrinë për një opinion ligjor, sepse ta kemi në rend dite një çështje e cila është obligim i KPF-së. E dyta, është shumë shpejt dhe e palogjikshme ta fusin si pikë shtesë buxhetin, i cili është vendimi më i rëndësishëm i komunës. Nuk e di ku është urgjencia, nëse bën që drejtori të na jep një shpjegim dhe nëse është e nevojshme mund të thërrasim seancë të jashtëzakonshme brenda muajit korrik. Mendoj që, nuk pajtohem që kjo të jetë si pikë shtesë në këtë seancë të rregullt.

**Afrim Limani:** I nderuar kryesues, nënkyetar dhe anëtarë të KPF-së. Konsideroj që në aspektin ligjor jemi në procedurë të rregullt për ta diskutuar KAB-in. E vetmja arsyë është që jemi pak me vonesë me dërgimin e materialit te anëtarët e KPF-së, sepse mbi bazën e kësaj qarkore buxhetore jemi detyruar ta përgatisim edhe KAB-in komunal. KAB-i në krahasim me vitet e tjera ka pësuar një ndryshim thelbësor, për shkak zvogëlimit të numrit të popullsisë. Kjo është arsyja juaj Burim, përndryshe besoj që jemi në rregull. Deri në seancën e rregull të kuvendit keni mjaft kohë për ta lexuar dhe analizuar.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, unë nuk kam arritur ta lexoj, kam arritur ta shoh KAB-in, sepse pardje pasdite na ka ardhur në email dhe është e pamundur për shkak të agjendave tona që i kemi, që brenda një dite ta levojmë dhe t'ia kushtojm gjithë kohën KAB-it. Nuk besoj që KAB-in mund ta analizojmë brenda një dite. Ndoshta ju që jeni pjesë

e ekzekutivit dhe që keni punë të përditshme me buxhetin është më e lehtë, sepse i njihni më mirë zhvillimet e komunës. Propozoj që ta thërrasim një seancë tjetër në korrik për diskutim të KAB-it dhe seancën e rregullt e mbajmë në fund të korrikut. Duhet të mësohet asambleisti t'ia kushton pak kohë punës, sepse pagat nuk janë të vogla dhe mbi 600€ i merr një asambleist për 1 herë në muaj këtu. Aq më shumë ka nevoj për diskutim, kur numri i banorëve ka ndikuar direkt te koeficienti i grantit qeveritar, i cili ndahet në bazë të numrit të banorëve dhe automatikisht është zvogëluar buxheti. Kam informacione jozyrtare të cilat mund të konfirmohen në të ardhmen, që prej Ministrisë së Arsimit ka vërejtje që numri i të punësuarve është më i madh se sa numri i nevojshëm. Njëjtë ka vërejtje edhe prej Ministrisë së Shëndetësisë që numri i të punësuarve është më i madh se sa numri i nevojshëm, gjithmonë duke u bazuar në numrin e banorëve. Për shkak të numrit të banorëve ka ra edhe buxheti i komunës dhe nuk e konsideroj që është një pikë e rendit të ditës që duhet të kalojë duke mos e diskutuar mirë, sepse situata me buxhetin e vitit 2026 dhe KAB-in 2026-2029 është më specifik se sa KAB-et dhe buxhetet e viteve të kaluara. Ju mund të vazhdoni tutje, por unë konsideroj që është veprim i ngutshëm i KPF-së dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme që të përgatitet asambleistët. Përndryshe, unë sot nuk kam çka të diskutojë hiç, sepse nuk kam arritur mjaftueshëm të bëj diskutim brenda për brenda.

**Afrim Limani:** Burim, të gjithë duhet ta dimë që data e fundit e dorëzimit të këtij dokumenti është 30 qershor. Në cilësi të drejtorit për Buxhet dhe Financa jam në gjendje që nesër ose pasnesër, apo kur të doni mbajmë edhe seancat tjera për diskutim. Duhet ta kemi parasysh që 30 qershor është data e fundit që duhet ta dorëzojmë qarkoren buxhetore dhe me këto limite duhet të aprovohet dhe të dorëzohet në departamentin e buxhetit.

**Nënkyetari:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të LMT-së dhe ju të pranishëm. Unë besoj që asgjë nuk është as e ngutshme, as e jashtëzakonshme. Krejt kjo është brenda afateve dhe në seancë të rregullt do ta keni materialin e KAB-it 2026-2028. E vetmja vërejtje që mund të jetë është dorëzimi i materialit në një afat të shkurtë, që anëtarët e KPF-së ta shtjellojnë materialin. Nesër e keni dëgjimin publik të KAB-it, ndërsa seanca mund të mbahet më 27, 28, 29 eventualisht 30 qershor, ku mund ta diskutoni detajisht. Materialin e kuvendit besoj që sot, ose nesër mund ta keni në email dhe besoj që është afat i mjaftueshëm për secilin kuvendor që njëmend e ka për qëllim shtjellimin e KAB-it. Përndryshe, sa i përket mospërputhjes të numrit të punëtorëvc në arsim dhe në shëndetësi, ne e kemi marr vesh numrin e popullsisë eventualisht në nëntor – dhjetor, para daljes së statistikave zyrtare dhe besoj që ju secilin e keni ditë që mbi bazën e numrit të popullsisë zvogëlohen edhe këto kategori, përfshirë edhe pagat.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkyetar! A kemi ndonjë diskutim tjetër?... Nëse jo, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota pro, 1 kundër dhe asnë abstenim, votohet pika shtesë e rendit të ditës. Tani e vendosim në votim komplet rendin e ditës. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota pro, 1 kundër dheasnë abstenim votohet rendi i ditës për mbledhjen e gjashtë të KPF-së.

## **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** Nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (4) aprovohet procesverbalii nga mbledhja e kaluar.

## **2. Shqyrtimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor) ZK-Rahovec:**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkyetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së, përfaqësues të KFOR-it. Para jush keni vendimin për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitut sendor). Me këtë vendim miratohet kërkesa e Avdurrahman Hysen Isma, Samir Xhemajli Rama dhe Njazi Asllan Shala nga Rahoveci. Bëhet fjalë për krijimin e qasjes – mundësisë së kalimit në pronë publike për tri parcela private me nr. 0897-1, 05471-0, 08970-2, për të tre personat e lartëcekur. Të gjitha këto parcela janë afër parcelës publike dhe përmes këtij vendimi këto tri parcela kanë të drejtë kalimi nëpër pronë publike.

**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje për të gjithë! Inderuar nënkyetar, kryesues, drejtorë, anëtarë të komitetit dhe ju të pranishëm. Drejtor, aty a ka parcela të tjera që nuk kanë qasje në rrugë dhe me të njëjtin vendim t'ju lejohet edhe atyre e drejta e kalimit, pavarësisht nëse ata nuk kanë pasur njohuri me situatën që po ndodh. Nëse ka parcela të tjera përfundi pronës private që komuna po ia lejon qasjen e kalimit në pronën publike, a mund të bien në ujdi që nëse ka prona private të tjera pa qasje në rrugë, atëherë të bëhet një marrëveshje: nëse komuna ia ofron një shërbim qytetarit, pse edhe ai mos të bën diçka në pjesën tjetër ku komuna nuk mund ta bëjë!? Përveç këtyre tri parcelave që po iu jepet e drejta për kalim, aty ka edhe parcela të tjera. Besoj që vendimi duhet të bëhet në një formë tjetër dhe të paktën të ketë një konsultim publik me pronarët e atyre parcelave, si dhe të biejmë në një ujdi që komuna iu krijon lehtësira atyre dhe në anën tjetër të gjithë bashkë të sigurojnë qasje (nëse nuk kanë) për të tjerët.

**Burim Krasniqi:** Parimisht pajtohem me propozimin e Defrimit që komuna të negociojë me banorët dhe të bëhet një zgjidhje për atë zonë. E dyta, në pozicionin që jemi si asamble duke pasur parasysh që është caktuar data e zgjedhjeve, a kemi të drejtë ligjore që ta bëjmë këtë veprim. Në bazë të ligjit në momentin që caktohet data e zgjedhjeve, asambleja nuk ka të drejtë të merr vendime që të jepen në shfrytëzim pronat apo diçka të ngashme. Ju lutem konsultoni zyrën ligjore, që ky vendim të cedohet në asamble apo jo!

**Erhan Morina:** Inderuar Defrim, realisht materialin c ka përgatitur drejtori i Kadastrit Afrim Oruqi, më shumë për detaje është i informuar ai dhe në mungesë të tij e prezentova pikën. Kjo kërkesë ka buruar prej këtyre trë palëve që janë të cekura në vendim dhe nuk e di saktësish nëse ka parcela të tjera. Qasja është lejuar për parcelat që preken direkt me pjesën publike. Sa i përket pjesës ligjore, kjo pikë e rendit të ditës ka kaluar kah zyra ligjore dbe besoj që kemi të drejtë.

**Burim Krasniqi:** Nuk e di nenin saktësish, por në momentin kur caktuhet data e zgjedhjeve, ligji nuk ia lejon asamblesë komuna të merr vendime të dhënies në shfrytëzim, në këtë rast edhe për servitut. Nuk dua të paragjykoj, por i kërkova kryesuesit veç le të konsultohet a jemi në rregull a jo? Para se të jetë kjo pikë në asamble komunale. Nuk kam dilemë që qytetarëve duhet t'ju bëjmë zgjidhje, por vetëm të mos ndodh që vendimi të rikthehet dhe MAPL të thotë që është joligjore.

**Nënkyetari:** Faleminderit kryesues! Se a ka prona të tjera që mund të kalojnë përmes pronës private e pastaj të kalojnë në pronën komunale. Realisht ne e kemi kërkesën e këtyre tre palëve dhe ata veçse janë duke kaluar aty. Në pronën publike që krijuhet servituti nuk ka të drejtë askush të ndalojë askënd, pavarësisht që servituti i jepet këtyre në shfrytëzim. Sipas zyrës ligjore, ky vendim është bërë duke u bazuar në ligjin për pronësinë dhe të drejtën sendore dhe nuk bazohet për ligjin për dhënien në shfrytëzim dhc sipas zyrës ligjore mund të trajtohen këto gjëra, si dhe shpresojmë që edhe MAPL do ta kthejë në favor të komunës.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkyetar! Atëherë, a kemi ndonjë diskutim tjetër?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e dytë e rendit të ditës.

### 3. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2028:

**Nënkyetari:** Para vetes e keni Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2028. E kemi vendimin për themelimin e ekipit për të drejtat e fëmijëve që është marrë më datë 30 mars 2023, si dhe mbledhjen konstitutive e cila u mbajt më datë 10 dhjetor 2024. Ky plan është 3-vjeçar. Është i paraqitur qëllimi dhe fusha e veprimit, si dhe objektivat mbi bazën e fushave të veprimit.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkyetar! Atëherë, a kemi ndonjë diskutim tjetër?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 6 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e tretë e rendit të ditës.

#### **4. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 nr.47/25, i datës 29.4.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV):**

**Erhan Morina:** Të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni vendimin, ku në bazë të këtij vendimi kërkohet të shfuqizohet vendimi me Nr. 47/25, i datës 29.4.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV). Pas kalimin në kuvend dhe pas shqyrtimit nga MAPL është kthyer e kundërligjshme, sepse në këtë parcelë parashihen aktivitetet: shërbim tregtar me shumicë, pakicë, riparim të automjeteve dhe mallra personale-shtëpiake. Pra, destinimi me PZhK-në e vitit 2023-2031 nuk përpushton. Me këtë vendim është kërkuar që të ndërtohet objekti për AUV-in. Kjo ka qenë arsyja e kthimit të kundërligjshëm nga ministria.

**Defrim Kafexhiu:** E kam një pyetje, por para se ta bëj pyetjen e kam një kritikë për ekzekutivit. Vetëm 2-3 drejtorë prezentë në KPF, nga 12 drejtorë sa janë. Kjo është neglizhencë totale dhe mungesë e respektit për institucionin dhe për secilin prej anëtarëve të KPF-së. Një pyetje e kam: Në parcelën e njëjtë (2 ha) dhe nëse nuk gaboj vendimin e kemi për 20 ari për dhënien në shfrytëzim për AUV-in. Pjesën tjeter të parcelës prej 1.8 ha, ne e kemi votuar në kuvend për dhënie në shfrytëzim. Nuk e di nëse janë zhvilluar procedurat e ankandit për këtë parcelë, por nuk e kemi pasur asnjëherë këtë problem. Pse ka ndodh pikërisht te kjo pjesa e kësaj parcele? Në kemi marrë në shfrytëzim parcela edhe prej Agjencionit të Pyjeve dhe më duket që arsyja e shfuqizimit nuk është shumë e mjaftueshme për këtë parcelë, duke pasur parasysh vlerën e investimit nga Agjencionit (700.000€).

**Burim Krasniqi:** Pa dashur të bëj politikë, kur ka investime mirësevinë. Drejtor dhe nënkyrjetar, të ia huqni me Plan Zhvillimor dhe vendimi të jetë në kundërshtim propozim-vendimi dhe vendimi i asamblesë është goxha joprofesionale. Një dokument që c ka bërë ekzekutivi me një kompani profesionale që e ka votuar legjislativi dhe të kërkonit ta ndani një parcelë për një veprimtari, e cila është në kundërshtim me PZhK-në dhe të vie puna që MAPL-ja ta kthejë, për mua është neglizhencë totale në këtë drejtim, ose nuk e kanë lexuar PZhK-në.

**Defrim Kafexhiu:** Drejtor, sa ditë kanë kaluar prej momentit që është dërguar vendimi në ministri, sepse me aq sa kam informatë unë, Agjencionit i ka zhvilluar edhe procedurat e prokurimit për planin e tyre në këtë parcelë. Nëse kanë kaluar 15 ditë, mendoj që vendimi është në fuqi.

**Erhan Morina:** Në përgjigjen e ministrisë është dhënë arsyetimi se Komuna e Rahovecit ende nuk e ka të miratuar Hartën Zonale dhe ka mbetur në kompetencë të komunës, që pas hartimit të Hartës Zonale ta shqyrtojë edhe një herë këtë vendim. Aktualisht me PZhK, nuk është e përcaktuar e drejta e ndërtimit në atë parcellë.

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit kryesues, përvendetje për të gjithë! I nderuar nënkyrjetar, të nderuar të pranishëm. Sa i përket këtij vendimi të MAPL-së, parcela në PZhK është e ndarë si zonë ndërtimore dhe e ka kategorinë për çka është e caktuar. Kërkesa prej AUV-it ka ardhur para 1 muaji dhe ne ia kemi lëshuar një pëlqim në parim, si dhe është pajisur edhe me kushte ndërtimore. Kur e kemi bërë që 20 ari prej parcelës së përgjithshme t'ia kalojmë Drejtorisë së Bujqësisë, ata e kanë kthyer si të paligjshme, sepse duhet të jetë edhe në PZhK. Këtë kërkesë nuk kemi mundur ta parashihnim, sepse ka ndodh pas Planit Zhvillimor. Me Ministrinë e Mjedisit kam biseduar edhe personalisht dhe kjo do të rregullohet me Hartën Zonale. Kushte ia kemi lëshuar, kontrata gjithashtu është nënshkruar. Sot kam qenë në terren me operatorin që e ka fituar kontratën, bashkë me zyrtarët e agjencionit. Lokacioni është ndarë dhe sa i përket komunës gjithçka është në rregull. Sipas kërkesës së ministrisë, gjatë miratimit të Hartës Zonale do të ndahet parcela prej 20 ari dedikuar posaçërisht për ndërtimin e AUV-it.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, nëse një investor privat do të aplikonte për një pëlqim për hotelieri-fabrikë, a do t'ja jipje?

**Albnor Mullabazi:** Po, parcela është zonë ndërtimore. I ka 4-5 nënkategori të tjera brenda PZhK-së.

**Burim Krasniqi:** MAPL-ja e ka kthyer, sepse pëlqimi ose vendimi i asamblesë është në kundërshtim me natyrën e veprimitave që guxojnë të ndodhin në atë parcelë. Çfarëdo vendimi i asamblesë është i kundërligjshëm, ose nuk është në vijë me PZhK-në. Nëse një investor privat do ta bënte një kërkesë të tillë, nuk do ta jepnim, e as ti nuk do

ta jepje, sepse nuk ka të drejtë. Nuk mund të themi që jemi në rregull me PZhK-në, sepse MAPL-ja po thotë që nuk jemi.

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit Burim! Sa i përket PZhK-së është treguar në vija të trasha që është zonë ndërtimore. Harta Zonale shkon në detaje të parcelave dhe ne nuk kemi mundur të dimë me PZhK, sepse nuk e kemi pasur në mend nëse mund të ndërtohet ndonjë objekt i AUV-it në Rahovec. Si tërësi është zonë ndërtimore dhe destinimi i parë i asaj zone është ndërtim. Ndërtimi tutje ka edhe nënkategori të tjera.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, a kemi ndonjë diskutim tjetër?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 6 vota pro, asnje kundër dheasnje abstenim votohet pika e katërt e rendit të ditës.

## 5. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, 2026-2028:

**Afrim Limani:** Faleminderit kryesues! Qarkorja e parë buxhetore ka ardhur më 16 maj dhe nga kjo datë e kemi analizuar, i kemi pa kufijtë buxhetor dhe mbi bazën e kësaj e kemi përgatitur KAB-in komunal. Kjo gjendje për neve është risi dhe konsideroj që këtu janë tre elemente që e veçojnë këtë qarkore dhe e emërueshin e përbashkët e kanë zvogëlimin e numrit të popullsisë. E thash që tri vëçuritë kryesore janë në buxhetin e arsimit, administratës dhe të shëndetësisë. Buxheti i administratës është i njëjtë me vitin e kaluar, mirëpo qeveria e ka buxhetuar në vlerë prej 677.000€. Viteve të tjera nuk do të përsëritet, sepse do të llogaritet me formulën në bazë të numrit të popullsisë. Te buxheti i arsimit ka ndodh kjo: numrin total të të punësuarve e kanë aprovuar, mirëpo buxhetimin e buxhetit e kanë bërë në bazë të numrit të popullsisë dhe në këtë rast 186 punëtorë janë më shumë. Atëherë, neve na takon që duhet ta buxhetojmë edhe këtë staf të punonjësve me vlerë 1.3 milionë. Zvogëlimi apo efekti negativ i regjistrimit të popullsisë nga 56.000 në 41.000 banorë ka reflektuar edhe në buxhetin e shëndetësisë. Këtu kemi zvogëlim të buxhetit në të gjitha kategoritë në total 91.979€. Pra, buxheti për vitin 2026 është 2.360.000€ dhe kur e krahasojmë me periudhën e vitit aktual është ky zvogëlim dhe në këtë sektor 46 punëtorë janë më shumë, që ne duhet t'i buxhetojmë me vlerë 600.000€. Si përfundim, në bazë të qarkores së parë buxhetore buxheti shpërndahet në kategori ekonomike si vijon: Pagat 12.4499.000€, që ka një rritje në raport me vitin aktual, prej 1.752.000€. Kategoria mallra dhe shërbime mbetet e njëjtë 2.761.000, shpenzimet komunali mbesin të njëjtë 390.000, subvencionet i kemi zvogëluar për 10.000€ dhe inestimet kapitale janë 4.897.000€. Mbi bazën e këtyre kufijve e kemi përgatitur edhe KAB-in komunal si dokument, me objektivat, zotimet, faktorët financiarë dhe synimet e qeverisë sipas drejtorive. Ky dokument duhet të votohet dhe afati i fundit për dorëzim në Ministri të Financave është 30 qershor.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, nëse e nxjerrim procesverbalin, në buxhetin e vitit 2025 e kam shprehur shqetësimin rreth mundësisë së zvogëlimit të buxhetit për shkak të zvogëlimit të numrit të popullsisë, sipas statistikave jozyrtare, por sipas informacioneve që i kishim. Në një seancë të radhës do ta prezantoj diskutimin që e kemi pasur, sepse është thënë që kjo punë nuk do të ketë efekt dhe do të tejkalohet. Rënia e buxhetit te pjesa e pagave, por edhe në përgjithësi ka qenë e pritshme, duke pasur parasysh koeficientin për numër të banorëve që e ndan qeveria. Kjo situatë ka mundur të jetë e menaxhueshme. Për një vit kemi shumë arsimtarë që kanë dalur në pension, por ju keni pranuar staf të ri. Nuk mund të thoni nuk e kemi ditur, kur e dimë saktësish se për sa banorë duhet të jetë një mjek dhe që një mjek duhet t'i ketë dy infermierë, është formulë e thjeshtë. A po i vendosni në sfidë arsimtarët për të ardhmen? Unë e di që jemi në vit zgjedhor dhe komuna bën çmos që të duket mirë. Nëse nuk ndryshon koeficienti i ndarjes së buxhetit për komuna dhe nëse nuk trajtohet ndryshe, kjo situatë do t'na përcjellë vazhdimisht. Unë i shoh si veprim politik të gjitha punësimet që kanë ndodh në komunën e Rahovecit për një vit. Ti e ke ditë shumë mirë drejtor, sepse je ekspert i fushës dhe të vlerësoj për nivelin profesional te financat. Në fund një pyetje joprofessionale: Nëse nuk miratohet buxheti, a aprovohet buxheti i vitit të kaluar? Ligji e thotë, atëherë mos ta aprovojmë dhe vjen buxheti i vitit të kaluar, i cili është më i mirë se ky.

**Afrim Limani:** Burim, i ngrite disa çështje për diskutim, për të cilat nuk doja t'ju merrja kohë. Nuk kemi besuar që popullsia do të ulet në këtë masë, 15 mijë më pak. Mos të harrojmë që kjo është vetëm qarkorja e parë buxhetore dhe ta shohim edhe qarkoren e dytë. Ky buxhet është i bazuar në ligjin e financave publike dhe përgjegjësive. Ky ligj është prodhuar në vitin 2002 dhe tutje është amandamentuar shumë pak. Një shembull: buxheti për shkolla ndahet 7€ për nxënës dhe tash kahasojeni 7€ në vitin 2002 dhe 7€ tani! Mendoj që ka ardhur koha që ky ligj duhet të amandamentohet. Shpresoj që qeveria do të ndërmerr diçka për këto komuna, që me regjistrim të popullsisë iu ka rënë buxheti shumë. Te tema e të punësuarve në shëndetësi, në aspektin ligjor jemi në rregull dhe për vitin 2025 janë të aprovuar të gjithë.

**Defrim Kafexhiu:** Dua të ndërlidhem pak te kjo teprica e të punësuarve. Ju me plot vetëdije e keni ditur gjendjen në arsim dhe gjendjen te numri i banorëve. Në një dëgjim buxhetor e ka thënë që numri i popullisë nuk ka rënë brenda një dite e as brenda një viti. Numri ka filluar të bie për një periudhë afatgjate dhe në këtë periudhë ju keni qenë në qeverisje. Realisht e keni ditur sa ka nevojë për mësimdhënësa dhe pavarësisht kësaj e keni bërë një kërkesë në Ministri të Arsimit që të shtohet "një" punëtor në arsim. Ministria e Arsimit nuk e din sa është numri i banorëve, këtë gjë e din Komuna e Rahovecit. Po ta dinte në këtë rast nuk do t'ju aprovonin. Ju kërkesa keni dërguar vazhdimi sh edhe duke e ditur gjendjen brenda komunës. Arsyetimi që ata vet e kanë aprovuar e në anën tjetër buxheti lëshohet sipas formulës, besoj që fajtorë te kjo pjesë jeni ju. Prapë po hapni konkurs, duke e ditur që 46 punëtorë në shëndetësi janë tepër dhe këta bëhen barrë që ju t'i merrni paratë prej një kategorie buxhetore tjetër. Kjo nuk është në rregull dhe dikush duhet ta mbajë këtë përgjegjësi! Ju ftoj që, në këtë periudhën e fundit të mandatit mos ta teproni me konkurse.

**Afrim Limani:** Defrim, ti fole drejt në parim, por këto fjali që i the tani është dashur t'i thuash tash një vit. Buxheti ka qenë i aprovuar. Numri i stafit të arsimit është aprovuar dhe buxheti është ndarë për numrin e aprovuar. Sivjet si ndryshim për herë të parë është përdorur formula dhe sipas Ministrisë së Arsimit ka ardhur në shprehje formula mësimdhënës – nxënës dhe i ka eleminuar 186 arsimtarë. Prej këtij viti ne duhet të shikojmë dhe të veprojmë në zvogëlim të stafit, sidomos në arsim.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim tjetër?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota pro, 1 kundër dhe asnë abstenim votohet pika e pestë e rendit të ditës.

##### 5. Të ndryshme:

**Burim Krasniqi:** Kërkoj që për seancë të kuvendit, ose para seancës t'i kemi dy informata shtesë: një prej Drejtorisë së Shëndetësisë dhe një prej Drejtorisë së Arsimit, pikërisht për çështjen e numrit të punonjësve, që pas përfundimit të numrimit të popullsisë, këta punonjës janë tepricë, në shëndetësi dhe në arsim. Këtë gjë nuk po e them unë, por e thonë raportet. Kërkoj që ta kemi edhe planin e daljes nga kjo situatë.

**Defrim Kafexhiu:** E kam një pyetje të lehtë. Shefi i grupit nuk ka pasur mundësi të jetë në këtë seancë dhe ma ka sugjeruar ta bëj një pyetje për punën e kompjuterëve që i kemi në kuvend komunal, si do të bëhet me punën e tyre?

**Kryesuesi:** Nëse nuk kemi pyetje të tjera, ju informoj që në mbledhjen e rregullt i kemi edhe këto pika: Shqyrtimi i informatës rreth aktiviteteve të KKSBB-së, për 6-mujorin e parë 2025, shqyrtimi i raportit rreth aktiviteteve të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, për 6-mujorin e parë 2025 dhe shqyrtimi i informatës për gjendjen me mbeturina në komunën e Rahovecit, për 6-mujorin e parë 2025. Ju falënderoj për vëmendjen dhe shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

